

Albsig Sh.a.

**Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013**

PËRMBAJTJA:

PASQYRA INDIVIDUALE E POZICIONIT FINANCIAR	5
PASQYRA INDIVIDUALE PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE	6
PASQYRA INDIVIDUALE E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	7
PASQYRA INDIVIDUALE E RRJEDHJES SË PARASË	8
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE INDIVIDUALE	9 - 43
SKEDULE SUPLEMENTARE	i-iii

Albsig Sh.a.**Pasqyra individuale e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2013***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

		Më 31 Dhjetor 2013	Më 31 Dhjetor 2012
	Shënime		
Aktivet			
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, neto	4	127,475,923	135,089,811
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara, neto	5	6,284,261	5,286,931
Investimet	6	1,012,113,870	1,010,366,027
Aktive të lidhura me risigurimin	7	18,304,983	10,299,313
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi	8	89,940,627	86,210,263
Aktive të tjera	9	39,331,087	30,810,771
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	10	102,004,502	79,912,914
Mjete monetare në arkë dhe në bankë	11	28,659,850	52,617,595
TOTAL I AKTIVEVE		1,424,115,103	1,410,593,625
Kapitali aksionar			
Kapitali i nënshkruar	12	879,460,000	879,460,000
Rezerva e katastrofës	13	5,400,000	5,400,000
Fitimi i akumuluar		45,640,076	55,048,346
TOTALI I KAPITALIT AKSIONAR		930,500,076	939,908,346
Detyrimet			
Rezervat teknike për dëmet	14	117,539,644	106,360,759
Rezervat e primit të pafiturar	15	269,012,043	287,748,238
Të pagueshme për risigurimet	16	10,663,982	3,623,566
Detyrime tatimore të shtyra	17	600,000	600,000
Tatim fitimi i pagueshëm		5,485,389	4,468,262
Detyrime të tjera	18	90,313,969	67,884,454
TOTALI DETYRIMEVE		493,615,027	470,685,279
TOTAL I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT AKSIONAR		1,424,115,103	1,410,593,625

Shënimet shoqëruese në faqet 9 deri 43 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

 Natasha Dhoqina
 Drejtor i Përgjithshëm

 Antoneta Mançellari
 Drejtore e Financës

Albsig Sh.a.**Pasqyra individuale përmbledhëse e të ardhurave për vitin e mbyllur më****31 Dhjetor 2013***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Prime të shkruara bruto	19	624,871,546	692,714,429
Ndryshimi në rezervën e primit të pafituar	15	18,736,195	(12,134,707)
Të ardhurat bruto nga primet e sigurimit		643,607,741	680,579,722
Prime të çeduar në risigurim	20	(58,338,826)	(49,486,321)
Ndryshimi në rezervën e primit të pafituar, pjesa e risiguruesit		8,005,670	10,204,514
Primet e fituara neto		593,274,584	641,297,915
Fitim/humbje neto nga këmbimet valutore	21	(2,316,111)	15,270
Të ardhura nga interesat	22	26,922,594	27,171,744
Të ardhura të tjera	23	58,106,041	19,628,199
Total i të ardhurave		675,987,108	688,113,128
Dëmet të ndodhura të sigurimit	14	(213,315,581)	(166,329,690)
Ndryshimi në provigjionimin e dëmeve	14	(11,178,885)	(20,933,461)
Ndryshimi në shpenzimet e shtyra te kostove te marrjes në sigurim	10	22,091,588	(16,343,303)
Kostot e marrjes në sigurim	24	(229,475,793)	(203,733,526)
Kontribute për Autoritetin Mbikqyrjes Financiare dhe Byronë e Sigurimeve	25	(37,506,676)	(37,356,029)
Shpenzimet administrative	26	(154,023,445)	(180,431,470)
Shpenzimet financiare		(1,460,388)	(847,841)
Totali i humbjeve dhe shpenzimeve		(624,869,180)	(625,975,319)
Fitimi para tatimit		51,117,927	62,137,809
Tatim fitimi	27	(5,485,389)	(7,097,000)
Fitimi i vitit pas tatimit		45,632,538	55,040,808
Të ardhura të tjera përmbledhëse		-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin		45,632,538	55,040,808

Shënimet shoqëruese në faqet 9 deri 43 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albsig Sh.a.**Pasqyra e levizjes se kapitalit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013**

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

		Fitimi i mbartur	Rezerva e katastrofës	TOTALI
Gjendja më 1 Janar 2012	879,460,000	61,007,537	5,400,000	945,867,537
Fitimi i vitit	-	55,040,808	-	55,040,808
Dividenti i deklaruar dhe i shperndare	-	(61,000,000)	-	(61,000,000)
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	879,460,000	55,048,346	5,400,000	939,908,346
Fitimi i vitit	-	45,632,538	-	45,632,538
Dividenti i deklaruar dhe i shperndare	-	(55,040,808)	-	(55,040,808)
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	879,460,000	45,640,076	5,400,000	930,500,076

Shënimet shoqëruese në faqet 9 deri 43 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albsig Sh.a.**Pasqyra e levizjes se likuiditetit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Rrjedhja e parasë nga aktiviteti operativ			
Fitimi neto para tatimit		51,117,927	62,137,809
Rregullime për të barazuar fitimin neto me rrjedhjen neto të parasë nga aktivitetet operative:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4 & 5	14,823,631	13,092,638
Humbje nga njerrja jashte perdorimit e aseteve materiale		400,974	
Të ardhurat neto nga interesi		(25,462,205)	(26,323,891)
Rrjedhja e parasë nga aktiviteti operativ përpara ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative		40,880,327	48,906,555
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet operative</i>			
Rritja në llogaritë e arkëtueshme të sigurimit	8	(3,730,365)	(4,184,682)
Ndryshimi ne provigjionet e risiguruesit	7	(8,005,670)	(10,204,514)
Ndryshimi në shpenzimet e shtyra te kostove te marrjes	10	(22,091,588)	16,343,303
Ndryshimi në aktivet e tjera	9	(8,520,316)	9,411,025
(Ulja)/rritja në të pagueshme për risigurimet	16	7,040,416	(326,690)
(Ulja)/rritja në detyrimet e tjera	18	22,429,514	(13,319,475)
Ndryshimi në provigjionet e primeve	15	(18,736,195)	12,134,707
Ndryshimi në provigjionet e dëmeve	14	11,178,885	20,933,461
Mjetet monetare neto të (përdorura)/gjeneruara nga aktivitetet operative		20,445,008	79,693,691
Tatimi fitimi i paguar		(4,468,262)	(2,698,914)
Interesi i paguar		(1,460,388)	(847,841)
Interesi i arkëtuar		29,291,043	25,898,133
Mjetet monetare neto nga aktivitetet operative		43,807,401	102,045,069
<i>Mjetet monetare nga aktivitetet e investimeve:</i>			
Blerja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	4	(5,790,409)	(19,198,993)
Blerja e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara	5	(2,817,638)	(2,898,454)
Rritja në investime	6	(4,116,293)	2,609,497
Rrjedhja e parasë e përdorur në aktivitetet		(12,724,340)	(19,487,949)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese			
Dividentet paguar ndaj aksionereve		(55,040,808)	(61,000,000)
Pjesmarrje ne Maqedoni			
Rrjedhja e parasë e përdorur në aktivitetet		(55,040,808)	(61,000,000)
Rritja/(zvoglimi) në mjetet monetare në arkë dhe bankë		(23,957,746)	21,557,120
Mjetet monetare në arkë dhe bankë në fillim të vitit		52,617,597	31,060,475
Mjetet monetare në arkë dhe bankë në fund të vitit		28,659,850	52,617,595

Shënimet shoqëruese në faqet 9 deri 43 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave finance

Albsig Sh.a.

Shënimet spjeguese të pasqyrave individuale për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

1 HYRJE

Albsig Sh.a. ("Shoqëria") është themeluar në vitin 2004 si një shoqëri sigurimi me vend ndodhje në Shqipëri. Shoqëria është një shoqëri aksionare me kapital të përbashkët, e regjistruar sipas Ligjit Shqiptar nr.7638, datë 19 Nëntor 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë me vendim të Gjykatës së Rrethit të Tiranës, Nr. 28154, datë 9 Janar 2004. Shoqëria operon sipas një liçence të lëshuar nga Autoriteti Mbikqyrjes Financiare ("AMF"), më përpara i njohur si Autoriteti Mbikqyrës i Sigurimeve ("AMS"), për tregtimin e policave të përgjithshme të sigurimit sipas rregullave të AMF-së në territorin e Shqipërisë. Autorizimi për të ndërmarrë aktivitetet e sigurimit të jo-jetës është marrë më datë 19 Qershor 2004 ndërsa liçenca që specifikon klasat e aktivitetëve është lëshuar më datë 10 Shtator 2004 nga AMS. Aktivitetet kryesore të biznesit përfshijnë dhënien e shërbimeve të sigurimit për mjetet motorrike, pasurinë, shëndetin, dhe produkte të tjera të sigurimit jo-jetë. Shoqëria ka 14 degë në Tiranë, Durrës, Dibër, Sarandë, Pogradec, Shkodër, Fier, Korçë, Elbasan, Vlorë, Lezhë, Kukës, Gjirokastrë dhe Berat.

Më 31 Dhjetor 2013, Shoqëria punësoi gjithsej 139 punonjës dhe drejtues (2012: 144).

Gjatë vitit 2007 Shoqëria filloi aktivitetin në territorin e Maqedonisë nëpërmjet ALBSIG A.D. Shkup ("Filiali"). Filiali është 100% i zotëruar nga shoqëria e sigurimit ALBSIG Sh.a. Tiranë, Shqipëri ("Shoqëria mëmë"). Filiali është regjistruar më 23 Prill 2007, është vendosur dhe funksionon në Republikën e Maqedonisë. Ai është liçensuar për të ofruar 12 klasa të sigurimit të jo-jetës; megjithatë aktivitetet kryesore të tij përfshijnë ofrimin e shërbimeve të sigurimit në fushat e mjeteve motorrike, pasurisë dhe ndaj aksidentëve.

2 ZBATIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË PËRDITËSUARA

2.1 Standardet e reja dhe ato të ndryshuara efektive për periudhat vjetore duke filluar më ose pas datës 1 janar 2013

SNRF 10 'Pasqyrat Financiare të Konsoliduara' (SNRF 10)

SNRF 10 zëvendëson SNK 27 'Pasqyrat Financiare Individuale dhe të Konsoliduara' (SNK 27) dhe KIS 12 'Konsolidimi-Njësitë ekonomike për qëllime të veçanta'. SNRF 10 rishikon përkufizimin e kontrollit dhe jep udhëzime të reja në zbatimin e tij. Këto kërkesa të reja mund të ndikojnë se cilat nga investimet e shoqërisë mund të konsiderohen filiale dhe në këtë mënyrë të ndryshojnë qëllimin e konsolidimit. Kërkesat mbi procedurat e konsolidimit, për llogari të ndryshimeve në interesat jo-kontrolluese dhe për humbjen e kontrollit të një filiali mbeten të pandryshuara.

Menaxhimi ka shqyrtuar vlerësimet e tij të kontrollit në përputhje me SNRF 10 dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka efekt në lidhje me klasifikimin (si filiale apo ndryshe) të çdo investimi të shoqërisë të mbajtur gjatë periudhës ose periudhave krahasuese të mbuluara nga këto pasqyra financiare.

SNRF 11 'Marrëveshjet e përbashkëta' (SNRF 11)

SNRF 11 zëvendëson SNK 31 'Interesat në Sipërmarrjet e Përbashkëta' (SNK 31) dhe KIS 13 'Njësitë Ekonomike nën Kontroll të Përbashkët- Kontribute Jo-Monetare nga Sipërmarrësit'.

SNRF11 rishikon kategoritë e marrëveshjeve së përbashkëta, dhe kriteret për klasifikimin në këto kategori, me objektivin për përafrimin e kontabilitetit me të drejtat dhe detyrimet e investuesit në lidhje me marrëveshjen.

Përveç kësaj, opsioni i SNK 31 për të përdorur konsolidimin proporcional për marrëveshjet e klasifikuara si njësi ekonomike nën kontroll të përbashkët është eliminuar. SNRF 11 tani kërkon

Albsig Sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave individuale për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

përdorimin e metodës së kapitalit për marrëveshjet e klasifikuara marrëveshje të përbashkëta (si për investimet në pjesëmarrje).

Zbatimi i SNRF 11 nuk ndikon materialisht pasqyrat financiare të shoqërisë.

SNRF 12 'Shënimet shpjeguese në lidhje me interesat në njësitë e tjera ekonomike' (SNRF 12)

SNRF 12 integron dhe i bën më të qëndrueshme kërkesat për shënime shpjeguese për lloje të ndryshme investimesh, duke përfshirë edhe njësitë ekonomike të strukturuar të pakonsoliduara. Ky standard paraqet kërkesa të reja për dhënie informacionesh shpjeguese në lidhje me rreziqet ndaj të cilave ekspozohet një shoqëri nga përfshirja e saj në njësitë ekonomike të strukturuar.

Zbatimi i SNRF 12 nuk ndikon materialisht pasqyrat financiare të shoqërisë.

Ndryshimet pasuese të SNK 27 'Pasqyrat Financiare Individuale' dhe SNK

28 "Investimet në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta" (SNK 28)

SNK 27 tani merret vetëm me pasqyrat financiare individuale. SNK 28 sjell investimet në sipërmarrjet e përbashkëta në objektin e saj. Megjithatë, kontabilizimi me metodën e kapitalit sipas SNK 28 mbetet i pandryshuar.

SNRF 13 'Matja e vlerës së drejtë' (SNRF 13)

SNRF 13 sqaron përkufizimin e vlerës së drejtë dhe jep udhëzime dhe shënime shpjeguese të zgjeruara që lidhen me matjet e vlerës së drejtë. Ky standard nuk ndikon në përcaktimin se cilët zëra është e nevojshme të maten me vlerën e drejtë. Qëllimi i SNRF 13 është i gjerë dhe aplikohet për zërat financiarë dhe jo-financiarë për të cilat SNRF-të e tjera kërkojnë ose lejojnë matjen me vlerë të drejtë ose dhënie informacionesh shpjeguese rreth matjes me vlerë të drejtë, përveç rrethanave të caktuara.

SNRF 13 zbatohet në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013. Kërkesat e këtij standardi për dhënie informacionesh shpjeguese nuk duhet të zbatohen për të dhënat krahasuese në vitin e parë të aplikimit. Megjithatë, shoqëria ka përfshirë si informacion krahasues shënime shpjeguese të SNRF 13 të cilat me përpara kërkoreshin nga SNRF 7 'Instrumentet financiare: Shënime shpjeguese'.

Shoqëria ka aplikuar SNRF 13 për herë të parë në vitin aktual.

Ndryshimet në SNK 19 Përfitimet e Punonjësve (SNK 19)

Rishikimet e SNK 19 bënë një numër ndryshimesh në kontabilizimin e përfitimeve të punonjësve.

Ndryshimi më i rëndësishëm ka të bëjë me skemat e përfitimeve të përcaktuara. Ndryshimet:

- eliminon "metodën e korridorit" dhe kërkon njohjen e ri matjes (duke përfshirë fitimet dhe humbjet aktuariale) që rezultojnë në periudhën raportuese në të ardhurat të tjera gjithëpërfshirëse
- ndryshon matjen dhe paraqitjen e disa komponentëve të kostove të përcaktuara të përfitimeve. Shuma neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve ndikohet nga heqja e kthimit të pritur mbi aktivet e skemës dhe komponentëve të kostos së interesit dhe nga zëvendësimin i tyre me një shpenzim ose të ardhur interesi neto, bazuar në aktivet ose detyrimet me përfitime të përcaktuara neto
- Zgjeron shënime shpjeguese duke përfshirë më shumë informacion në lidhje me karakteristikat e skemave të përfitimeve të përcaktuara dhe rreziqeve të lidhura me to.

Zbatimi i ndryshimeve të SNK 19 nuk ndikon materialisht pasqyrat financiare të shoqërisë.

Albsig Sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave individuale për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

Ndryshimi i SNRF 7, 'Instrumentet financiare: shënimet shpjeguese', mbi netimin e aktiveve dhe detyrimeve

Ky ndryshim përfshin dhënien e informacioneve shpjeguese të reja për të lehtësuar krahasimin midis atyre njësive ekonomike që përgatisin pasqyrat financiare sipas SNRF-ve dhe atyre që përgatisin pasqyrat financiare në përputhje me PPPK të SHBA. Zbatimi i këtij ndryshimi nuk ndikon materialisht pasqyrat financiare të shoqërisë.

Përmirësimet vjetore 2009-2011 (Përmirësimet vjetore)

Përmirësimet vjetore 2009-2011 (Përmirësimet vjetore) bënë disa ndryshime të vogla në një numër të caktuar të SNRF-ve. Ndryshimet e rëndësishme për shoqërinë janë përmbledhur si më poshtë:

Sqarimi i kërkesave mbi pasqyrën e hapjes së pozicionit financiar:

- Sqaron se data e përshtatshme për hapjen e pasqyrës së pozicionit financiar është fillimi i periudhës pasuese (shënimet shpjeguese në lidhje me këtë nuk janë më të nevojshme të paraqiten)
- adreson kërkesat krahasuese mbi pasqyrën e hapjes së pozicionit financiar kur një njësi ekonomike ndryshon politikat kontabël apo bën riparaqitje apo riklasifikime retrospektive në përputhje me SNK 8.

Sqarimi i kërkesave për informacionin krahasues të dhënë përtej kërkesave minimale:

- sqaron se informacioni shtesë për pasqyrat financiare nuk është i nevojshëm të paraqitet në formën e një pakete të plotë të pasqyrave financiare për periudhat përtej kërkesave minimale
- kërkon që çdo informacion shtesë i paraqitur duhet të paraqitet në përputhje me SNRF dhe njësia ekonomike duhet të paraqesë informacion krahasues në shënimet përkatëse në lidhje me atë informacion shtesë.

Efekti tatimor i shpërndarjes të mbajtësit e instrumenteve të kapitalit:

- trajton një mospërputhje të perceptuar midis SNK 12 'Tatimi mbi fitimin' dhe SNK 32 'Instrumentet financiare: Paraqitja', në lidhje me njohjen e pasojave të tatimit mbi të ardhurat që lidhen me shpërndarjet të mbajtësit e një instrumenti të kapitalit dhe për kostot e transaksionit për një transaksion kapitali.
- sqaron se qëllimi i SNK 32 është që të ndjek kërkesat e SNK 12 për kontabilizimin e tatimit mbi të ardhurat që lidhet me shpërndarjet të mbajtësit e një instrumenti kapitali dhe për kostot e transaksionit të një transaksioni të kapitalit.

Informacioni i segmentit për totalin e aktiveve dhe detyrimeve:

- sqaron se totali i aktiveve dhe detyrimeve për një segment të veçantë raportues kërkohej të paraqitet në shënimet shpjeguese nëqoftëse dhe vetëm nëqoftëse: (i) një matje e totalit të aktiveve apo totalit të detyrimeve (apo të dyjave) i jepet në mënyrë të rregullt drejtorit të vendim-marrjes operative; (ii) ka patur një ndryshim material nga matja e paraqitur në shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare vjetore më të fundit për atë segment raportues.

Përmirësimet vjetore të përmendura më sipër janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013. Menaxhimi nuk parashikon efekte të rëndësishme nga këto ndryshime në pasqyrat financiare të shoqërisë.

2.2 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e bëra në lidhje me standardet që nuk janë efektive dhe që nuk janë adoptuar me përpara nga ana e shoqërisë

Në datën e autorizimit të pasqyrave financiare, disa standarte të reja, ndryshime dhe interpretime të standarteve ekzistuese ishin publikuar nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit

Albsig Sh.a.

Shënimet spjeguese të pasqyrave individuale për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

(BSNK) por që nuk janë bere akoma efektive dhe nuk kane qene te adoptuara me pare nga Shoqëria (me perjashtim te ndryshimeve ne SNK 1 te permendur me siper ne noten 2.1).

Drejtimi i Shoqërisë parashikon që të gjitha deklaratimet do të adoptohen ne politikat kontabël te shoqërisë ne momentin që këto deklarime do të behën efektive. Informacionet ne lidhje me standartet e reja, ndryshimet dhe interpretimet që priten te jene te rëndësishme për pasqyrat financiare te Shoqërisë parashitohen me poshtë. Disa standarte dhe interpretime te tjera që janë publikuar nuk pritet që te kenë ndikim material ne pasqyrat financiare te shoqëri

SNRF 9 Instrumentet Financiare (SNRF 9) – BSNK synon te zëvendësoje SNK 9 “Instrumentet Financiare”: Njohja dhe matja ne tërësinë e tyre”, SNRF 9 po publikohet me faza. Deri tani, seksionet ne lidhje me njohjen, klasifikimin, matjen dhe mosnjohjen e aktiveve financiare dhe detyrimeve janë publikuar. Këto seksione do te jene efektive ne 1 janar 2015. Disa seksione ne lidhje me metodat e zhvlerësimit dhe me kontabilitetin mbrojtës janë ne zhvillim e sipër. Drejtimi i shoqërisë ka ende për te vlerësuar ndikimin e këtij standarti te ri ne pasqyrat financiare. Megjithatë, drejtimi i shoqërisë nuk do te implementoje SNRF 9 deri ne momentin që te gjitha seksionet do te publikohen ne mënyre që vlerësojnë ndikimin e te gjitha ndryshimeve.

3 POLITIKAT BAZË KONTABËL

3.1 Të përgjithshme

Pasqyrat financiare individuale shoqëruese janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (“BSNK”) dhe interpretimet e publikuara nga Komisioni i Interpretimeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“KINRF”) të BSNK. Pasqyrat financiare individuale shoqëruese janë për qëllim të përgjithshëm dhe jo për ndonjë transaksion me qëllim të veçantë.

Auditimi i pasqyrave financiare të Shoqërisë është kryer jo për ndonjë qëllim specifik dhe ky auditim nuk ishte i planifikuar, projektuar dhe realizuar për ndonjë përdorues të veçantë por vetëm për qëllime të përgjithshme. Kështu që, përdoruesit e pasqyrave financiare dhe të këtij raporti auditimi duhet të ndërmarrin procedura të tjera të përshtatshme dhe hetime përpara marrjes së vendimeve. Në veçanti, auditimi ynë nuk ishte planifikuar, projektuar dhe kryer si rezultat i kërkesave apo veprimeve të transaksioneve të veçanta të propozuara nga aksionarët e Shoqërisë. Si rrjedhim, çështje të ndryshme, në lidhje me transaksionet e propozuara nga aksionarët, mund të mos jenë trajtuar në mënyrë specifike.

3.2 Baza e përuethshmërisë

Pasqyrat individuale financiare janë përgatitur mbi bazat e kostos historike dhe të paraqitura në monedhën Shqiptare LEKË.

Këto pasqyra financiare paraqesin rezultatin dhe pozicionin financiar të Shoqërisë më vete dhe nuk përfshijnë atë të filialeve. Pasqyrat financiare të konsoliduara, të cilat përfshijnë rezultatet dhe pozicionin financiar të filialeve, do të lëshohen më vete.

Në përputhje me SNRF 4 Kontratat e Sigurimit, Shoqëria ka aplikuar politikat kontabël në fuqi për kontratat e sigurimit për secilën nga degët e saj, të modifikuara për të qënë në përputhje me SNRF. Si rrjedhim filialet dhe degët në vënde të ndryshme duke përdorur standartet lokale, mund të kenë politika kontabël të ndryshme për kontratat e sigurimit sipas SNRF 4.

Albsig Sh.a.

Shënimet spjeguese të pasqyrave individuale për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

3.3 Raportimi në operacionet e huaja

i. Filialet

Shoqëria ka filial në Maqedoni nën pronësinë dhe kontrollin e saj të plotë. Filiali është i raportuar në kosto në këto pasqyra individuale financiare minus humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka.

3.4 Klasifikimi i produktit

Produktet e Shoqërisë janë klasifikuar në fillim, për qëllime kontabilizimi, si kontrata të sigurimit. Një kontratë, e cila është klasifikuar si një kontratë sigurimi mbetet si e tillë derisa të gjitha të drejtat dhe detyrimet të kenë përfunduar, ose nuk janë më të vlefshme.

Kontratat sipas të cilave, Shoqëria pranon rrezik domethënës sigurimi, nga një palë tjetër (policëmbajtësi), duke rënë dakord për të kompensuar policëmbajtësin ose përfitues të tjerë, nëse një ngjarje specifike e pasigurtë në të ardhmen (ngjarja e siguruar), ndikon policëmbajtësin ose përfitues të tjerë, janë klasifikuar si kontrata sigurimi. Risku i sigurimit ndryshon nga risku financiar. Risku financiar është risku i ndryshimit në të ardhmen në një ose më shumë norma interesi specifike, çmime sigurie, çmime produkti, ndryshime në kurset e këmbimit, çmimet ose normat e indeksit, normat, indekset ose variabla të tjerë të kreditimit, të parashikuara në rastin e variablave jo financiar si variabla që nuk janë specifik për një pjese të kontratës. Kontratat e sigurimit gjithashtu mund të sjellin risk financiar.

3 POLITIKAT BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

3.5 Njohja dhe matja e kontratave

i. Primet

Primet nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Primet e shkruara përfshijnë primet në kontrata që e kanë filluesin në vitin financiar, pavarësisht nëse lidhen me një pjesë ose tërësisht me periudhat e ardhshme kontabël. Primet përfshijnë komisionet e pagueshme ndaj ndërmjetësve dhe paraqiten neto nga taksat e pagueshme mbi to. Pjesa e fituar e primeve të shkruara njihet si e ardhur. Primet janë fituar që nga data kur Shoqëria ndërmerr riskun, gjatë periudhës së demit, bazuar në modelin e riskut të nënshkruar.

Rezerva për primet e pafituara

Rezerva për primet e pafituara përfshin pjesën e primit të shkruar bruto e cila është parashikuar të fitohet në vitin pasardhës financiar duke përdorur bazë ditore (metodën 1/365), e përshtatur sipas nevojës për të reflektuar ndonjë ndryshim në riskun e ndodhjes së demit gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata.

Rezerva për primet e pafituara për Kartonin Jeshil, TPL, Kufitare llogaritet sipas Vendimit.

ii. Dëmet

Dëmet e ndodhura nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Dëmet e ndodhura nga sigurimet e aktivitetit të përgjithshëm përbëhen nga dëmet e paguara për policëmbajtësit gjatë vitit financiar së bashku me ndryshimet në vlerësimin e detyrimeve për dëmet pezull.

Albsig Sh.a.

Shënimet spjeguese të pasqyrave individuale për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

Dëmet pezull përfshijnë rezervat për parashikimet e Shoqërisë për shlyerjen përfundimtare të të gjitha dëmeve të ndodhura por të pa paguara në datën e raportimit e të raportuar ose jo, dhe shpenzimet e brëndshme ose të jashtme për dëmet si dhe një marzh sigurie.

Ndërsa drejtuesit konsiderojnë që rezerva bruto për dëmet dhe mbulimet e risigurimit të lidhura me to janë përcaktuar saktë mbi baza të informacionit aktual të mundshëm për to, detyrimi më i fundit mund të variojë si rezultat i informacionit dhe ngjarjeve në vijimësi dhe mund të rezultojë në korrigjime domethënëse të shumave të rezervuara. Korrigjimet e shumave të rezervave të dëmeve të vendosura në vitet paraardhës janë reflektuar në pasqyrat financiare të periudhës tek të cilat janë bërë rishikimet.

Rezerva e dëmeve

Rezerva perfaqëson vlerësimin e kostos përfundimtare të shlyerjes së të gjitha dëmeve, duke përfshirë kostot direkte dhe indirekte të shlyerjes së dëmit, të cilat lindin nga ngjarje që kanë ndodhur deri në datën e raportimit. Humbjet e papaguara dhe rregullimet e shpenzimeve të humbjes përbëhen nga vleresime për humbjet e raportuara dhe rezervat për humbjet e paraportuara.

Metoda e përdorur për të përcaktuar rezervën e dëmeve, është bazuar në rregullat statutoire të mëposhtme të zbatueshme por është mbështetur gjithashtu nga vlersimet aktuariale.

Rezervat e sigurimit më 31 Dhjetor 2013, janë ekuivalente me ato të aprovuara nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare në përputhje me Nenin 101, 111, dhe 112, pika 1 (ç) të Ligjit “Mbi Aktivitetin e Sigurimit, Risigurimit dhe Ndërmjetësimeve në Sigurime dhe Risigurime” Nr. 9267 datë 29 Korrik 2004, dhe Neni 14, pika 9 i Ligjit “Mbi organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve” Nr. 9572, datë 3 Korrik 2006.

Në përputhje me Ligjin Shqiptar të Sigurimeve dhe direktivave të tjera të lidhura me të, rezerva për dëmet e raportuara por jo të paguara (“RBNS”) përcaktohet duke u zbatuar në çdo rast individualisht

3 POLITIKAT BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

3.5 Njohja dhe matja e kontratave (vazhdim)

në përputhje me praktikën më të mira të specialistëve të sigurimit. Rezerva është llogaritur si shuma e pritur për të paguar dëmin dhe parashikimet janë korrigjuar sipas informacionit të ri të mundshëm. Rezerva e ndodhur por e pa raportuar është vlerësuar bazuar në metodologjinë e trekëndëshit të dëmeve për TPL dhe Kasko dhe parashikuar duke përdorur një metodë raportimi të thjeshtë bazuar në krahasimin e dëmeve të raportuara në vitin e vëzhguar dhe të ndodhura në vitet paraardhës, siç lejohet nga praktikë lokale për linja e tjera të biznesit.

iii. Risigurimi

Shoqëria çdon primet e sigurimit dhe riskun për të limituar humbjet e mundshme lindur nga ekspozimi në risqe të konsiderueshme nga TPL, Prona, Karton Jeshil ,Casco dhe linjat e biznesit si marina dhe aviacioni.

Ky risigurim përfshin marrëveshjet e tejkalimit të humbjeve dhe marrëveshjet fakultative. Vetëm kontratat që shkaktojnë transferim domethënës të rrezikut të sigurimit dhe rrezikut kohor janë kontabilizuar si risigurime. Marrëveshjet e risigurimit nuk lehtësojnë Shoqërinë nga detyrimet direkte të saj ndaj policëmbajtësve. Detyrimet e risigurimit përfshijnë llogaritë e pagueshme për kontratat e risigurimit dhe janë njohur si shpenzim bazuar në të gjithë shumën e rënë dakord me risiguresin.

Shumat e rimbursuara janë paraqitur në pasqyrën individuale përmbledhëse të të ardhurave dhe në pasqyrën individuale të pozicioni financiar. Mbulimet e parashikuara nga risigurimi janë paraqitur veçmas si aktive në pasqyrën individuale të pozicioni financiar. Risigurimet dhe mbulime të tjera janë

Albsig Sh.a.

Shënimet spjeguese të pasqyrave individuale për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

vlerësuar në mënyrë të ngjashme me vlerësimet e dëmeve pezull në mënyrë konsistente me shumat e lidhura me kontratat themelore të sigurimit dhe në përputhje me termit e kontratave të risigurimit.

Aktivitetet e risigurimit përfshijnë shumat për t'u arkëtuar nga shoqëritë e risigurimit për dëmet dhe primet e pafituara të risiguruara.

Aktivitetet e risigurimit janë objekt i testimit të zhvlerësimit. Zhvlerësimi i aktiveve është objektiv nëse ka evidencë të mjaftueshme që Shoqëria nuk do të jetë e aftë të marrë shumat nga risiguruesit. Nëse ka evidencë të zhvlerësimit, shumat e mbartur e aktivitetit të risigurimit zvogëlohet në shumën e tij të rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet si një shpenzim në pasqyrën përmbledhëse individuale të të ardhurave.

Shumat e rikuperueshme nga risigurimi aprovohen çdo vit nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare në përputhje me Nenin 101 të Ligjit "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetsimit në sigurime dhe risigurime" Nr. 9267 datë 29 Korrik 2004, dhe Nenin 14, pika 9 e Ligjit "Mbi organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve" Nr. 9268, datë 29 Korrik 2004.

iv. Testi i mjaftueshmërisë së rezervave

Në çdo datë raportimi Shoqëria kryen testimin për tu siguruar për mjaftueshmërinë e rezervave të dëmeve. Testimet kryesore që kryen janë: Analiza e Raportit të Dëmeve dhe Analiza e Zhvillimit të Provigjoneve të Dëmeve.

Analiza e Raportit të Dëmeve kryhet çdo vit dhe individualisht në pjesën më të madhe të linjave të biznesit. Llogaritja bëhet vetëm mbi dëmet dhe mbi dëmet që përfshijnë edhe koston e marrjes në sigurim dhe kosto të tjera të jashtme të lidhura me dëmin. Në kryerjen e kësaj analize Shoqëria merr në konsideratë parashikimet aktuale të rrjedhjeve dalëse të parasë. Shoqëria nuk i skanton këto rrjedhje të parashikuara të parasë sepse shumica e dëmeve priten të paguhen brenda vitit.

Në vazhdim, Shoqëria kryen një analizë vjetore të zhvillimit të Provigjonimit të dëmeve për vlerësimin e metodologjisë së Provigjonimit. Kjo analizë kryet mbi RBNS dhe IBNR në baza individuale dhe të kombinuara. Në rast se analiza shfaq mospërputhje të madhe, korrigjimet e duhura bëhen në metodën e provigjonimit.

Nëse identifikohet një pamjaftueshmëri e rezervave, ajo do t'i ngarkohet menjëherë shpenzimeve duke krijuar një rezervë risku të paskaduar nga humbjet që rezultojnë nga Testi i Mjaftueshmërisë së Rezervave.

3.6 Kosto e marrjes në sigurim

Kostot e marrjes në sigurim përcaktohen si kosto që lindin nga lidhja e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë kostot direkte, si komisionet e blerjes dhe kosto e hartimit të dokumentave të sigurimit, dhe një pjesë të shpenzimeve administrative të lidhura me procesin e shitjes dhe emetimit të policave.

Kostot e dëmeve konsistojnë në shpenzimet e jashtme të dëmit dhe nuk përfshijnë shpenzime të brëndshme të dëmit të cilat janë menduar të mos jenë të rëndësishme krahasuar me kostot e jashtme. Shoqëria krijon një tolerancë për kostot e dëmeve me rezervat që lidhen me dëmet. Marrja në sigurim paraqet kostot direkte të jashtme siç janë komisionet e agentëve, kostot e botimeve dhe marketingut. Kosto të tilla janë shtyrë si zbritje nga rezerva e primeve të pafituar.

Kostot e marrjes në sigurim përfshijnë edhe bonuset (komisionet) e paguara për agentët. Këto shpërblime i janë dhënë agentëve të Shoqërisë me qëllim rritjen e përqindjes që zë Shoqëria në treg. Shpërblimet janë të vendosura paraprakisht.

Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim pasqyrojnë atë pjesë të shpenzimeve që janë paguar por nuk i perkasin periudhës ushtrimore. Shpenzimet e marrjes në sigurim njihen pasqyrën përmbledhëse individuale të të ardhurave në përpjestim me kohëzgjatjen e primeve të sigurimit për të cilat janë paguar.

Albsig Sh.a.

Shënimet spjeguese të pasqyrave individuale për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

3.7 Konvertimi nga monedha e huaj

i. Monedha funksionale dhe e prezantimit

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare të njësive të Shoqërisë janë matur duke përdorur monedhën kryesore ekonomike të vendit ku operon njesia (monedha funksionale).

Pasqyrat financiare individuale janë paraqitur në Lekë, që është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

ii. Transaksionet dhe tepricat e llogarive

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të kompanive individuale, transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale e njësisë (monedhat e huaja) regjistrohen me kurset e këmbimit në datën e transaksionit. Në çdo datë raportimi, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kurset e datës së raportimit. Diferencat nga këmbimet valutore njihen në fitim ose humbje të periudhës në të cilën ndodhin.

iii. Veprimtaritë e huaja

Rezultati dhe pozicioni financiar i degëve të huaja që kanë monedhë funksionale të ndryshme nga monedha e prezantimit rivlerësohen në monedhë funksionale si më poshtë:

Aktivitet dhe detyrimet për çdo gjëndje të paraqitur këmbehen me kursin e mbylljes në datën e raportimit.

3.7 Konvertimi nga monedha e huaj

Të ardhurat dhe shpenzimet për çdo pasqyrë të ardhurash rivlerësohen me kurset mesatare të këmbimit (derisa kjo diferencë nuk është një përafrim i arsyeshëm i efektit kumulativ të kurseve të ditës së transaksioneve, në të tilla raste të ardhurat dhe shpenzimet rivlerësohen me datën e transaksionit).

Të gjitha rezultatet nga diferencat e këmbimeve njihen si një përbërës i veçantë në kapital.

Kursi zyrtar i zbatueshëm i Bankës (Leku kundrejt monedhës së huaj) për monedhat kryesore të përdorura më 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 është si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
	Mbyllje	Mbyllje
Dollari Amerikan (USD)	101.86	105.85
Njesia monetare e BE (EUR)	140.20	138.59

3.8 Njohja e të ardhurave

i. Primet

Politikat kontabel për njohjen e të ardhurave nga kontratat e sigurimit janë paraqitur në shënimin 3.4.

ii. Të ardhura nga interesi

E ardhura nga interesi njihet në bazë të të drejtave të konstatuara mbi principalin pezull, dhe duke përdorur normën efektive të atë spe.

Albsig Sh.a.

Shënimet spjeguese të pasqyrave individuale për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

iii. Të ardhura nga qiraja

Të ardhurat nga qiraja njihen me bazë rrjedhëse.

3.9 Shpenzimet

i. Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

ii. Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore

Shoqëria paguan vetëm kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat u sigurojnë punonjësve përfitimet pensioni pas shkëputjes nga puna. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për të përcaktuar kufirin e vendosur minimal për pensionet në vëndet përkatëse sipas një plani të përcaktuar kontributesh pensioni. Kontributet e Shoqërisë për planin e pensionit paraqiten në pasqyrën përmblendhëse individuale të të ardhurave kur ndodhin.

iii. Pagesat e qerave operative

Pagesat e bëra për qeratë operative njihen në pasqyrën përmblendhëse individuale të të ardhurave në përpjestim me kohëzgjatjen e kontratës së qirasë.

3.10 Instrumentat financiare

i. Klasifikimi

Investimet e mbajtura deri në maturim janë aktive financiare me pagesa të përcaktuara fikse dhe maturim fikse të cilat drejtimi i Shoqërisë ka qëllimin dhe aftësinë për t'i mbajtur deri në maturim.

ii. Njohja

Investimet e mbajtura deri në maturim njihen në ditën kur ato i transferohen Shoqërisë.

iii. Matja

Instrumentat financiare maten fillimisht me kosto, përfshirë dhe koston e transaksionit. Të gjitha detyrimet financiare të pa tregtueshme, kreditë e nisura dhe llogaritë e arkëtueshme dhe aktivet e mbajtura deri në maturim maten me koston e amortizimit minus kostot e humbjeve nga zhvlerësimi. Kosto e amortizuar llogaritet me metodën e normës efektive të interesit. Metoda e normës efektive të interesit është një metodë e llogaritjes së koston së amortizuar të një aktivi financiar dhe të shpërndarjes së të ardhurave nga interesi sipas periudhës që i takon. Primet dhe skontot, që përfshijnë kostot fillestare të transaksionit, janë përfshirë në shumën e mbartur të instrumentave të lidhura dhe amortizohen bazuar në normën efektive të interesit të instrumentit, kur është e zbatueshme.

iv. Instrumenta specifik

Mjetet monetare në arkë dhe bankë

Mjetet monetare në arkë dhe bankë përfshijnë gjendjet e arkës, llogaritë rrjedhëse në bankat tregtare dhe investimet në depozita shumë likuide me maturim deri në 3 muaj që nga data e blerjes, që janë gati të konvertueshme në një shumë të njohur monetare dhe janë subjekt i një risku jodomethënës të ndryshimeve në vlerë.

Albsig Sh.a.

Shënimet spjeguese të pasqyrave individuale për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

Investimet në kapital

Investimet në kapital janë aktive financiare që nuk kanë një çmim tregu të kuotuar dhe të cilave vlera e drejtë nuk mund t'i matet me besueshmëri. Keto instrumenta maten me kosto.

Depozitat me afat

Depozitat me afat janë paraqitur në pasqyrën individuale të pozicionit financiar me shumën e principalit të pasqyrës dhe janë klasifikuar në bazë të maturitetit të tyre. Depozitat me afat me maturitet më pak se 3 muaj janë klasifikuar si mjete monetare në arkë dhe bankë, ato me maturitet mbi 3 muaj klasifikohen si depozita me afat. Interesi është llogaritur me bazë rrjedhëse.

v. Ç'regjistrimi

Një aktiv financiar çregjistrohet kur Shoqëria e humbet kontrollin mbi të drejtat kontraktuale që përmban ai aktiv. Kjo ndodh kur të drejtat janë realizuar, janë maturuar ose janë dorëzuar. Një detyrim

3 POLITIKAT BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

financiar çregjistrohet kur detyrimi nuk ekziston më. Një detyrim financiar çregjistrohet atëherë dhe vetëm atëherë kur detyrimet e Kompanisë janë shlyer, fshirë ose i ka mbaruar afati.

3.11 Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

Aktivitetet e qëndrueshme të trupëzuara janë vlerësuar me koston e blerjes duke zbritur zhvlerësimin e akumuluar. Zhvlerësimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara llogaritet mbi vlerën e mbetur të tyre. Toka dhe aktivitetet në proces nuk zhvlerësohen:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Ndërtesa dhe përmirësime infrastrukture	5%	5%
Makineri dhe pajisje	20%	20%
Pajisje zyre	20%	20%
Mjete transporti	20%	20%
Mobilje dhe orëndi	20%	20%
Pajisje kompjuterike dhe programe (software)	25%	25%

Vlera e mbetur, nëse nuk është e parëndësishme, duhet të rishikohet çdo vit. Përmirësimet teknike kapitalizohen dhe zhvlerësohen përgjatë afatit më të shkurtër midis afatit të qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

3.12 Llogari të arkëtueshme të sigurimit dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe të tjera mbahen me koston e tyre minus humbjet nga rënia e vlerës, (shih shënimin 3.14).

3.13 Llogari të pagueshme të sigurimit dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme të sigurimit dhe të tjera mbahen me kosto.

3.14 Zhvlerësimi

Albsig Sh.a.

Shënimet spjeguese të pasqyrave individuale për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

Vlera e mbartur e aktiveve të Shoqërisë rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për një rënie të mundshme të vlerës. Objekti i evidencës të zhvlersimit për një portofol llogarish të arkëtushme mund të përfshijë eksperiencën e shkuar të Shoqërisë të mbledhjes së pagesave, një rritje në vonesat e pagesave të portofolit, siç mund të jenë ndryshimet e dallueshme në kushtet e ekonomisë lokale ose kombëtare që lidhen me vonesa në llogaritë e arkëtueshme.

Në qoftë se një tregues i tillë ekziston, vlerësohet shuma e rikuperueshme nga ky aktiv. Një humbje nga rënia e vlerës njihet kurdoherë që vlera e mbartur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga rënia e vlerës njihen në pasqyrën përmbledhëse individuale të të ardhurave përveç rasteve kur një aktiv paraqitet i rivlerësuar dhe në këtë rast njihet si zvogëlim i rivlerësimit.

3.15 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin është njohur në pasqyrën përmbledhëse individuale të të ardhurave dhe paraqet shumën e tatimeve të pagueshme dhe të shtyra.

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, i cili llogaritet duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit dhe ndonjë rregullim të tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme.

Fitimi fiskal ndryshon nga fitimi neto i raportuar në pasqyrën përmbledhëse individuale të të ardhurave sepse përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në vitet e tjera dhe gjithashtu përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që nuk janë asnjëherë të tatueshme ose të zbritshme.

Tatimi i shtyrë kontabilizohet duke përdorur metodën e detyrimeve të bilancit kontabël dhe llogaritet si tatimi i pritur për tu paguar ose për tu arkëtuar nga diferencat e përkohshme midis vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale. Shuma e tatimit të shtyrë të lejuar bazohet në mënyrën e parashikuar të realizimit ose pagesës të shumave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur normat fiskale të miratuara ose që priten të miratohen me siguri në datën e raportimit.

Tatimi i shtyrë llogaritet me normën e taksës që është parashikuar për tu zbatuar në periudhën kur detyrimi paguhet ose aktivi të realizohet dhe ngarkohet në pasqyrën përmbledhëse individuale të të ardhurave, përveç kur është e lidhur me zërat e ngarkuar atë s në atë sp. Në të tilla raste tatimi i shtyrë është gjithashtu pjesë e kapitalit.

3.16 Gjykime kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit

Shoqëria bën parashikime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve për vitin e ardhshëm financiar. Parashikimet dhe gjykimet janë vazhdimisht të vlerësuara dhe bazohen në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë parashikimet e ngjarjeve të ardhshme që besohet se janë të arsyeshme dhe të përshtatshme sipas rrethanave. Parashikimet dhe supozimet themelore rishihen mbi bazën e vazhdimësisë. Rishikimet e parashikimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën është inspektuar nëse rishikimi ndikon vetëm periudhën ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme nëse rishikimi ndikon në periudhën aktuale dhe të ardhshme së bashku.

Dëmet dhe përfitimet e policëmbajtësit

Parashikimi i detyrimeve më të fundit që vijnë nga dëmet nën kontratat e sigurimit është parashikimi kontabël më kryesor i Shoqërisë. Vendimet e Shoqërisë për humbjet e raportuara dhe të pa raportuara dhe krijimi provigjioneve që rezultojnë dhe risigurimet e rikuperueshme rishikohen dhe rinfreskohen çdo

Albsig Sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave individuale për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

vit dhe rregullimet që rezultojnë nga ky rishikim reflektohen në të ardhura. Proçesi nuk mbështetet në supozimet bazë që eksperiencat e shkuara, të rregulluar për efekt të zhvillimeve aktuale dhe tendencave të pritshme, janë një bazë e përshtatshme për parashikimin e ngjarjeve të ardhshme. Metodat e përdorur nga Shoqëria në përcaktimin e provigjioneve janë bazuar mbi kërkesat lokale të zbatueshme, megjithatë llogaritjet e aktuarëve janë bërë që të sigurojnë saktësinë e tyre. (shih shënimin 3.5 (ii).

3.17 Shifrat krahasuese

Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim janë riklasifikuar nga rezerva e primeve të pafituara si aktiv me vete në pasqyrën e pozicionit financiar.

Të gjitha ndryshimet në politikat kontabël janë aplikuar në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 "Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet kontabël dhe Gabimet.

.

